



WORLD BANK GROUP

RAPORTI I RREGULLT EKONOMIK PËR BALLKANIN PERËNDIMOR
Nr.20 | Vjeshtë 2021

SHQIPËRIA

RIMËKËMBJE E GJELBËR - SHËNIMET PËR SHTETE



Shqipëria

- Rimëkëmbja ekonomike e Shqipërisë në vitin 2021 është më e fortë nga sa ishte parashikuar, si rezultat i rigjallërimit të sektorit të udhëtimit, ndërtimit dhe industrisë nxjerrëse dhe rritjes së investimeve private, konsumit dhe shpenzimeve publike.
- Rimëkëmbja është mbështetur nga politikat makroekonomike, megjithëse rritja e shpenzimeve publike ka çuar në një rritje të mëtejshme të raportit të borxhit ndaj PBB-së.
- Rikuperimi i punësimit dhe pjesëmarrjes në forcën e punës ka qenë më i ngadaltë, ndërsa pagat reale janë në rritje.
- Pasiguria ekonomike mbetet e lartë në kushtet e rritjes së rritjes së rasteve të infektimit me COVID-19 dhe shkallës së ulët të vaksinimit.

Zhvillimet e Fundit Ekonomike

Pasi u godit rëndë nga pandemia, ekonomia shqiptare ka nisur të rimëkëmbet në 2021.

PBB-ja në vitin 2020 ra me 4 për qind, dhe qeveria rriti borxhin publik për të zbutur humbjet ekonomike nëpërmjet rritjes së shpenzimeve. Rritja ekonomike u përshpejtua me 5.5 për qind në tremujorin e parë (TM1) të vitit 2021. Megjithëse shumica e sektorëve përjetuan rimëkëmbje ekonomike, sektorët me kontributin më të lartë ishin energjia dhe ndërtimi, përkatësisht me 1.7 dhe 1.1 pikë përqindje, ku kontributi i sektorit të ndërtimit ishte pjesërisht i lidhur me përpjekjet për rindërtim pas tërmetit të vitit 2019. Për sa i përket shërbimeve, vetëm aktivitetet e tregtisë vijuan me trend rënës. Përmirësimi i treguesve të besimit të biznesit, shtimi i lejeve të ndërtimit dhe rritja në tregtinë e jashtme dhe të ardhurat fiskale tregojnë se përshpejtimi i ritmit të rritjes ekonomike do të vijojë dhe përgjatë tremujorit të dytë. Numri i turistëve që kanë hyrë në vend në shtatë muajt e parë të vitit 2021 ishte vetëm pak më i ulët krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2019, gjë që tregon për një rikuperim të fortë të turizmit gjatë muajve të verës.

Rritja e shkallës së vaksinimit, remitanca, kredisë dhe rigjallërimi i aktivitetit ekonomik të partnerëve tregtarë përmirësuan besimin e konsumatorit dhe biznesit dhe rritën kërkesën e brendshme, e cila u zgjerua me 4.8 për qind në terma vjetorë në TM1 2021.

Kontributi më i madh erdhi nga investimet, të cilat patën një rritje vjetore me 21.1 për qind, dhe konsumi publik, i cili pësoi një rritje me 5.2 për qind në terma vjetore. Megjithë rikuperimin, konsumi privat vijon të jetë ende nën nivelin e para-pandemisë dhe në linjë me rikuperimin me ritme më të ngadalta të tregjeve të punës. Për vitin 2021, PBB-ja parashikohet të rritet me 7.2 për qind.

Tregu i punës filloi të rikuperohet në TM2. Në

TM1 2021, tregu i punës vijoi të tkurret për sa i përket punësimit dhe pjesëmarrjes në fuqinë punëtore, kryesisht për shkak të punësimit në bujqësi. Në TM2 punësimi përjetoi një rritje marginale prej 1.1 për qind për shkak të zgjerimit të punësimit në ndërtim dhe prodhim, ndërsa bujqësia vazhdoi të tkurret. Edhe pjesëmarrja në forcën e punës u rrit me 1 për qind; rreth 34,000 punëtorë u larguan nga forca e punës në TM2 2021 në krahasim me nivelin parapandemisë të TM2 2019. Norma e papunësisë u zvogëluar në 11.6 për qind nga

11.9 për qind në të njëjtin tremujor të vitit 2020. Pagat reale në sektorin formal u rritën me 2.9 për qind në TM2 2021, pjesërisht për shkak të një rritje në pagën minimale.

Presionet inflacioniste kanë filluar të shtohen.

Goditjet nga ana e ofertës, rritja e inflacionit në partnerët tregtarë dhe zgjerimi i kërkesës nxitën një rritje të inflacionit vjetor në 1.8 për qind në tremujorin e dytë krahasuar me 0.9 për qind në tremujorin e parë. Ndikimin më të madh në këtë rritje e patën çmimet e ushqimeve dhe naftës. Për shkak se punësimi nuk ka filluar ende rikuperimin, presionet e brendshme inflacioniste vijnë të mbeten të zbehta¹, por pritet që ato të intensifikohen me zgjerimin e kërkesës dhe stimujt e vazhdueshëm monetarë dhe fiskalë. Megjithatë inflacioni po fillon të rritet sërish, prishmëritë për të janë akoma të pandryshuara, prandaj, politika monetare vijoi të mbështeste kërkesën duke e mbajtur normën bazë të interesit në minimumin e saj historik. Premia e ulët e rrezikut të likuiditetit në tregun e brendshëm financiar siguroi një transmetim të butë të stimullit monetar në norma më të ulëta të interesit në tregun e parasë, letrat me vlerë të qeverisë dhe kredinë për sektorin privat. Kreditë konsumatore me hipotekë dhe kreditë për investime për bizneset çuan në një zgjerim të kredisë për sektorin privat me 7.7 për qind në terma vjetorë në qershor 2021.

Pavarësisht të ardhurave më të larta, deficitet fiskal mbetet i lartë.

Të ardhurat buxhetore në gjashtëmujorin e parë të vitit 2021 ishin 20.1 për qind më të larta në terma vjetorë dhe 3.6 për qind mbi nivelin e së njëjtës periudhë në vitin 2019. Kjo rritje reflekton në një masë të madhe efektin bazë statistikor, pasi tremujori i dytë i vitit 2020 shënoi kulmin e kufizimeve

në lëvizje dhe aktivitetin ekonomik. Rritja e importeve të mallrave të akcizës dhe, në një masë më të vogël, rritja e çmimeve të mallrave, ka ndikuar gjithashtu në të ardhurat nga tatimi mbi vlerën e shtuar (TVSH), të cilat kontribuan me 5.2 pikë përqindje në rritjen e të ardhurave totale. Deficiti për gjysmën e parë të vitit ishte 25 për qind më i ulët se e njëjta periudhë në vitin 2020. Qeveria gjithashtu uli detyrimet e prapambetura të rimbursimit të TVSH-së prej 10 miliardë lekësh.² Rritja e të ardhurave të mbledhura dhe borxhi i ri i krijuan qeverisë mundësinë të rrisë shpenzimet. Nëpërmjet një akti normativ, në korrik 2021, qeveria pezulloi përkohësisht rregullin fiskal për një raport në rënie të borxhit ndaj PBB-së të përcaktuar në Ligjin e Buxhetit Organik, dhe shtyu objektivin e arritjes së një bilanci primar pozitiv në 2024.³

Borxhi publik pritet të pësojë sërish rritje.

Qeveria përmbushi me sukses nevojat e saj për financim nëpërmjet emitimit të Eurobondeve në vitin 2020, e cila e çoi borxhin në një nivel tjetër të lartë prej 78.6 për qind në raport me PBB-në. Ndërkohë, vendi nuk ka amortizues të mjaftueshëm në rast të përballjes me një valë të re pandemike. Në mungesë të konsolidimit fiskal, shtërëngimi i kërkesës dhe rritja e normave të interesit në tregun financiar ndërkombëtar mund të çojnë në shfaqjen e riskut të rfinansimit.

Disbalancat e jashtme u ngushtuan gjatë gjysmës së parë të vitit 2021.

Flukset hyrëse të remitancave dhe teprica në tregtinë e shërbimeve kompensuan kërkesën e rritur për mallra importi, një tregues ky i rritjes së investimeve dhe konsumit. Llogaria rrjedhëse u

1 Inflacioni bazë vijoi të jetë i qëndrueshëm në 1.4 përqind.

2 Pagesat e prapambetura për rimbursimin e TVSH-së rezultojnë në zbritjen e tyre nga të ardhurat bruto dhe nuk regjistrohen si zë më vehte në llogaritë financiare të qeverisë.

3 Rregulli fiskal përfshin një klauzolë përjashtuese në rastet e rrethanave të emergjencave, e cila u zbatua në vitin 2020.

ngushtua me 9.6 për qind në gjysmën e parë të vitit. Remitancat u rritën me 24.4 për qind në terma vjetorë. Investimet e huaja direkte (IHD) pësuan një rënie të vogël, me 1.7 për qind, por trendi i tyre ishte në rritje në tremujorin e dytë, veçanërisht për hidrokarburet. Stoku i rezervave, i cili vlerësohet se mbulon 8.4 muaj importe, u rrit akoma më shumë gjatë muajit gusht pas alokimit nga Fondi Monetar Ndërkombëtar të të Drejtave Speciale të Tërheqjes (SDR) ekuivalente me 160.7 milionë euro për rezervat e vendit.

Perspektiva dhe Rreziqet

Parashikimi për rikuperimin e fortë të ekonomisë me 7.2 për qind në vitin 2021 bazohet në vijimin e procesit të vaksinimit, mungesën e mbylljeve të tjera për shkak të pandemisë, dhe vijimin e rimëkëmbjes të sektorit të shërbimeve, të udhëhequr nga turizmi dhe ndërtimi. Në planin kohor afatmesëm, konsumi privat parashikohet të jetë sërish nxitësi kryesor i rritjes së PBB-së. Investimet private mund të sigurojnë mbështetje të mëtijshme për rritjen ekonomike nëse zbatohen reformat për përmirësimin e klimës së biznesit. Ndërkohë, deficitin e llogarisë korrente pritet të zgjerohet në 9.4 për qind të PBB-së, pasi rritja e kërkesës për investime në infrastrukturë do të sjellë rritjen e importeve me 29 për qind në vitin 2021. Rikuperimi i eksporteve pritet të sjellë tkurrjen graduale të deficitit të llogarisë korrente deri në 7.0 për qind në vitin 2023. Eksportet e shërbimeve, përfshirë turizmin dhe zgjerimi i shpejtë i operacioneve të procesit të biznesit, duhet të çojnë në ngushtim të deficitit aktual të llogarisë në periudhën afatmesme.


Rritja e fortë ekonomike pritet të nxisë rritjen e të ardhurave publike në 27.4 për qind të PBB-së gjatë viteve 2022–25. Pas vitit 2021, shpenzimet ka të ngjarë të tkurren për shkak të hapësirës së kufizuar fiskale, duke qenë se raporti i borxhit publik ndaj PBB-së parashikohet të rritet në 78.6 për qind në 2021, dhe më pas të ulet gradualisht në periudhë afatmesme.

Megjithatë, parashikimet ekonomike mbeten të pasigurta për shkak të rritjes së numrit të infektiveve ditore nga COVID-19 në këtë periudhë. Gjithashtu, shkalla e vaksinimit deri në gusht 2021 ishte vetëm rreth 20 për qind e popullsisë. Rivendosija e masave kufizuese për kontrollin e përhapjes së infektiveve do të vononte rimëkëmbjen e aktivitetit ekonomik dhe punësimin, veçanërisht në sektorët e shërbimeve dhe prodhimit.

Sipas këtij skenari pesimist të rritjes ekonomike dhe në mungesë të përmirësimit të performancës në mbledhjen e të ardhurave, hapësira fiskale mund të vijojë të përkeqësohet. Sipas këtij skenari, qeverisë mund t'i duhet të shkurtojë shpenzimet kapitale për të parandaluar një rritje të raportit të borxhit ndaj PBB-së. Për më tepër, varësia gjithnjë e më madhe tek financimi i jashtëm do të bëjë që rreziku i kursit të këmbimit, rreziku i normave të interesit dhe ai i rifinancimit të mbeten të lartë. Një nga prioritetet kyçe të reformës afatmesme është rritja e performancës në mbledhjen e të ardhurave dhe arritja e konsolidimit fiskal duke krijuar hapësirë për shpenzime që forcojnë rritjen ekonomike.

Aktiviteti ekonomik pritet të rimëkëmbet në 2021.


Kontributet në rritjen ekonomike, pikë përqindje



Burimi: INSTAT; përlogaritje të stafit të Bankës Botërore.

Për të mbështetur ekonominë u përdorën stimuj të fortë fiskalë, por duke shkaktuar rritje të borxhit publik.


Për qind e PBB-së



Burimi: INSTAT; MFE; përlogaritje të stafit të Bankës Botërore.

Rritja e kredive mbështeti zgjerimin e kërkesës.


Percent



Burimi: Banka e Shqipërisë; përlogaritje të stafit të Bankës Botërore.

Tregu i punës nuk është rikuperuar ende.


Në përqindje



Burimi: INSTAT.

Presionet inflacioniste po shtohen.


Në përqindje



Burimi: Banka e Shqipërisë; përlogaritje të stafit të Bankës Botërore.

Deficiti i llogarisë korrente u ngushtua dhe pjesërisht u financua nga IHD-të dhe huamarrja e qeverisë.

In million EUR, 4q rolling sum



Burimi: Banka e Shqipërisë; përlogaritje të stafit të Bankës Botërore.

SHQIPËRIA	2018	2019	2020	2021e	2022f	2023f
Rritja e PBB-së Reale (në përqindje)	4.1	2.2	-4.0	7.2	3.8	3.7
Përbërja (pikë përqindje):						
Konsumi	3.1	2.5	-3.8	3.9	1.9	2.7
Investimet	0.7	-0.9	-1.0	3.1	-0.4	0.5
Eksportet neto	0.2	0.6	0.8	0.2	2.3	0.5
Eksportet	1.4	2.0	-8.6	6.6	3.9	2.1
Importet (-)	1.1	1.4	-9.4	6.4	1.6	1.6
Inflacioni i çmimeve të konsumit (në përqindje, mesatare e periudhës)	2.1	1.4	1.6	2.4	2.8	3.0
Të ardhura publike (për qind e PBB-së)	27.5	27.2	26.3	27.8	27.4	27.4
Shpenzimet publike (për qind e PBB-së)	29.2	29.2	33.2	34.4	30.2	30.4
Prej të cilave:						
Shpenzime për paga (për qind e PBB-së)	4.5	4.6	4.8	5.0	4.5	4.4
Asistencë sociale (për qind e PBB-së)	11.6	11.9	12.9	12.6	12.0	11.8
Shpenzime kapitale (për qind e PBB-së)	4.8	4.5	6.3	7.5	5.6	5.1
Bilanci fiskal (për qind e PBB-së)	-1.7	-1.9	-6.8	-6.7	-2.8	-3.0
Bilanci primar fiskal (për qind e PBB-së)	0.5	0.1	-4.7	-4.6	-0.7	-0.6
Borxhi Publik (për qind e PBB-së)	64.9	63.7	75.1	75.4	74.9	73.1
Borxhi publik dhe i garantuar (për qind e PBB-së)	69.5	67.4	77.2	78.6	76.7	74.9
Prej të cilit: I Jashtëm (për qind e PBB-së)	30.4	29.1	35.9	38.6	35.3	32.4
Eksportet e mallrave (për qind e PBB-së)	7.7	6.6	6.1	7.6	7.5	7.5
Importi i mallrave (për qind e PBB-së)	30.1	29.7	28.9	33.9	33.5	33.1
Eksportet neto të shërbimeve (për qind e PBB-së)	8.7	9.3	8.1	10.6	13.0	13.6
Bilanci tregtar (për qind e PBB-së)	-13.7	-13.8	-14.7	-15.7	-13.0	-12.0
Fluksi hyrës i remitancave (për qind e PBB-së)	5.2	5.2	5.1	4.7	4.7	4.7
Bilanci i llogarisë korrente (për qind e PBB-së)	-6.8	-8.0	-8.8	-9.4	-8.1	-7.0
Flukset hyrëse të Investimeve të huaja direkte (për qind e PBB-së)	8.0	7.6	6.8	6.6	7.4	7.0
Borxhi i jashtëm (për qind e PBB-së)	65.2	60.5	64.7	59.3	53.9	52.9
Rritja reale e kredimit privat (në përqindje, mesatare e periudhës)	-3.0	1.5	5.2	—	—	—
Kreditë me probleme (përqindje e totalit të kredive, fundi i periudhës)	11.1	8.4	8.1	—	—	—
Norma e papunësisë (në përqindje, mesatare e periudhës)	12.3	11.5	11.7	—	—	—
Norma e papunësisë e të rinjve (në përqindje, mesatare e periudhës)	23.1	21.5	20.9	—	—	—
Shkalla e pjesëmarrjes në forcën e punës (në përqindje, mesatare e periudhës)	59.4	60.4	59.5	—	—	—
PBB për frymë, PPP (Dollarë ndërkombëtar korrent)	15,101	15,433	14,816	—	—	—
Shkalla e varfërisë (në përqindje të popullsisë)	32.4	31.8	32.6	30.8	29.3	—

Burimet: Autoritetet e Vendit, Vlerësime dhe parashikime të Bankës Botërore.

Shënim: Norma e papunësisë për të rinjtë i referohet forcës së punës në grupmoshën 15–29 vjeç. Mospërputhja statistikore në kontribut është shpërndarë në raportin 80 përqind me 20 për qind midis Konsumit dhe Investimeve përkatësisht. Ndryshimi në inventare është përfshirë në Investime.

Shikoni raportin online:
www.worldbank.org/eca/wbrer

